



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 165 , Datë 22.10.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KODIT TË MATJES TË GAZIT
NATYROR”.**

Në mbështetje të nenit 16; të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4 pika 39, nenit 104 pika 1, nenit 116 pika 4 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 114/2 Prot, datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të matjes të Gazit Natyror”,

Konstatoi se:

- Referuar Nenit 104, pika 1 të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, ERE miraton Kodin e Matjes për sistemet e matjes dhe matjen e gazit natyror, të hartuar nga operatorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.
- ERE në mënyrë të përsëritur i është drejtuar Operatorit të Kombinuar të Sistemit të Transmetimit, shoqërisë Albgaz sh.a., me kërkesën për draftimin e këtij dokumenti, por në mungesë të një dokumenti të draftuar dhe propozuar nga Operatori, si edhe për shkak të tejkalimit të afatit përcaktuar në nenin 116, pika 4 të Ligjit për gazin, ERE draftoi këtë dokument.
- “Kodi i matjes” është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e gazit natyror.
- Kodi i Matjes përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes të Gazit Natyror, që do të jetë i përshtatshëm për matje, për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas Rregullave të Tregut dhe Marrëveshjeve midis Palëve
- Draft Kodi i Matjes së Gazit Natyror u hartua si dokument në zbatim të Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, dhe si pjesë e veçantë nga Kodi i Transmetimit të Gazit në Shqipëri.
- Drafti i Kodit të Matjes, do të konsultohet me të licencuarit në sektorin e Gazit Natyror si dhe gjithë Palët e Interesit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Kodit të Matjes të Gazit Natyror”.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI